

KATERINA POLADJAN

Hic sunt leones

Roman

Përktheu nga gjermanishtja:
Feride Xh. Berisha

Shtëpia Botuese PA
Prishtinë 2022

Libri

1915: Një bibël e vjetër e një familie armene në bregdetin e Detit Të Zi ishte gjëja e vetme që u kishte mbetur Anahidës dhe Hrantit gjatë arratisjes. Njëqind vjet më vonë Helenes, një restaurueses së re, i ofrohet një bibël për ta restauruar. Helena futet thellë në enigmën e librit të vjetër, në Armeninë moderne dhe në një histori mërgimi, të humbjes dhe të dhimbjes, që përcillet nga brezi në brez.

Hic sunt leones ose *Hic sunt dracones* (*Këtu janë luanët, Këtu janë dragonët*) është një shprehje e njohur latine që lidhet me hartat e lashta. Shprehja përkufizon hapësira të rrezikshme, që duheshin shmangur nga ushtria apo udhëtarët e ndryshëm. Në harta, zonat përkatëse ishin të zbrazëta, ose të bardha.

Autorja

Katerina Poladjan u lind në Moskë dhe sot jeton në Berlin. Hic sunt leones është libri i saj i katërt, që shkroi në gjermanisht. Ajo mori çmime të shumta dhe ndër të tjerat edhe Nelly-Sachs-Preis në vitin 2021, Rheingau Literatur Preis 2022 dhe Chamisso-Preis Dresden 2022.

Përkthyesja

Feride Berisha me prejardhje nga Kosova, përkthen vepra nga autore(ë)t gjermane(ë) në gjuhën shqipe. Në vitin 2021 për punën e saj në përkthimin e veprës „Proza e vogël“ të Robert Walserit mori mirënjohje nga Deutscher Übersetzerfonds 2021/2022. Është studiuese e veprave të Hans Fallada, Max Frischit dhe Robert Walserit. Jeton dhe punon në Berlin.

HIC ET NUNC

Ndez dritën e tavanit. Nëpër shumë tavolina gjenden të shpërndarë grumbuj letrash dhe tuba pergamenësh. Thith erën e dheut, vezëve dhe mykut, pluhur druri dhe kafshe të hershme. Fryma ime përshkon mbështjellësin, fryma ime është tepër e ngrohtë, edhe lëkura ime është tepër e ngrohtë. Punoj pa dorëza, mendoj. Faqet e librit janë shkukur nga ballina e tyre mbrojtëse dhe janë renditur me kujdes në grumbuj. Para shumë kohësh ky libër me siguri futej nën jastëkun e një të sëmuri dhe, në mëngjesin tjetër, pritej me frikë zgjimi i tij, lëvizja e lehtë e syve si fillim i shërimit. Ndoshta pemët kishin genë të zhveshura, ndoshta lopa nuk kishte tagji, ndoshta ishte zhvendosur mali i njohur. Në bodrumet dhe në hapësirat e arkivit ruhen shtatëmbëdhjetëmijë dorëshkrime dhe libra, harta, foliante, gravura nëpër rafte, sirtarë dhe kasaforta dhe, njëheresh krahas zhurmës së ventilatorit, ua dëgjoj çdo herë e më qartë fjalët dhe zërat.

STAMBOLLI

Në autobus nga një aeroport në tjetrin, përjashta një rrëmujë prej taksish dhe njerëzish, isha prapë në Stamboll.

Pesë gjilpëra, pesë fije mëndafshi, dy të zeza, dy të kuqe, një e bardhë.

Në çdo stacion njerëzit shtyheshin gjithnjë e më shumë. Unë kisha një ulëse, ëndërroja nga pak, jo tamam. Një nënë e re ma uli fëmijën e saj në prehër, e bëri pa fjalë dhe vetëkuptueshëm. Fëmija rrinte urtë, vetëm një herë e ktheu kokën kah unë dhe më kundroi. Nuk po ecë autobusi, thashë unë. Fëmija qeshi, turqishtja ime pas gjithë atyre viteve tingëlloi e çalët.

Peri i kuq në vrimën e gjilpërës, të bardhin menjëherë pas, të shtrëngohet fort.

Në sheshin Taksim duhej ta ndërroja autobusin. Kisha edhe pak kohë dhe u ula në sallën hyrëse të hotelit Marmara. Porosita çaj dhe i telefonova Tarikut. Gjatë qëndrimit tim në Stamboll para dhjetë vitesh kisha banuar tek Tariku dhe nëna e tij. Asokohe sapo i kisha përfunduar studimet për histori arti, i kisha shtuar edhe disa semestra për orientalistikë dhe mendja ime ishte lodhur me teorira. Më merrte malli për materie konkrete dhe aplikova për të bërë praktikë në bibliotekën Sylejmanie. U trajnova për restaurim dorëshkrimesh të vjetra, dhe për herë të parë mbaja në duar libra të shekullit të X-të. Kur u ktheva në Gjermani, braktisa planin për të promovuar dhe nisa të mësoja zanat tek një libralidhës.

I bardhë, i kuq, i bardhë, peri i zi përfundi, nyje për nyje, të shtrëngohet fort, edhe më fort.

Tariku dukej sikur nuk u çudit nga telefonata ime. Para dhjetë vitesh ma kishte treguar qytetin, fillimisht një qemer në themelet e një pallati bizantin, ku gjendeshin kuti me shishe, patike, tigane. Një herë tjetër, në një oborr kishte hapur një kapak të ndryshkur dhe ne zbritëm shumë shkallë, duke kapërcyer mbeturina dhe minj gjirizi të ngordhur. Tariku foli mes të shtyllave të një havuzi të lashtë për furnizimin me ujë, që në këtë qytet pat qenë gjithmonë një sfidë. Dhe kur unë në kësi vendesh kisha frikë nga tërmeti, që do të na mbulonte përgjithmonë me dhé, atij i vezullonin sytë nën dritën e një llambe dore dhe më pëshpëriste: tërmet – më pëlqen kur natyra ua rikujton njerëzve kufijtë.

Tariku është një filolog i latinishtes dhe i greqishtes, bibliofil, mbledh xhevahire, dhe ai hap pas hapi ndjek njohuritë për pluhurin dhe shtresimet gjatë viteve dhe shekujve. Nëse sjell ndërmend tavolinën e tij, shoh të hapur mbi të një botim në greqishten e vjetër të *Iliadës*. Nëse sjell ndërmend zërin e tij, dëgjoj poezi të Gëtes dhe Herderit, të cilat i reciton rrjedhshëm sikurse vargjet e Omar Khajamit: Ashtu si bilbili i dehur gjeti rrugën për në kopsht, erdh' ajo tekanjoze dhe më foli në vesh, kupto se jetën e shkuar askush s'gjet. – Përfërsisht kështu.

Tariku dhe nëna e tij banonin në një shtëpi tradicionale prej druri me pamje kah Bosfori. Megjithatë, as druri i vjetër osman dhe as pozita e mirë nuk u ndihmonin të tejkalonin vështirësitë financiare dhe ata lëshonin me qira një dhomë të bukur në katin e parë. Prej atje shkoja çdo ditë tek porti i trageteve, dhe pastaj, me anije, nëpër udhëkryqin ujqor mes Evropës dhe Azisë. Tariku më përcillte shpesh dhe, kur në pranverën

e hershme, delfinët kërcenin mbi sipërfaqe të ujit, thoshte: këndon, ju duhet të këndon Helen, sepse nga Herodoti e dimë që këto gjallesa i kishin shpëtuar jetën Arionit, këngëtarit mitik, kur disa cuba të etur për pará e kishin hedhur nga anija. Sapo arrinim në Eminëny, Tariku më jepte një shami freskuese, merrte një edhe për vete dhe i pastronte duart, dhe neve na vinte erë limoni nga Çeshme-ja apo e livandës nga Burdur-i.

Me vite të tëra s'e kisha parë e as kisha folur me Tarikun, dhe shumë rrallë i kishim shkruar ndonjë rresht njëri-tjetrit.

„Ju jeni në Stamboll, Helenë?“ Tariku ngulte këmbë tek Ju-ja, edhe pse ne disa herë ia kishim ofruar njëri tjetrit ti-në.

„Jo, vetëm kalimthi. Dua të shkoj në Lindje, së pari në Ordu. Prej aty ka një lidhje me autobus për në Kars. Aeroplani im nisat në orën katër.“

„Çka në Anadoll? *Hic sunt leones*, patën shkruar në kohët e lashta në pjesët e zbrazëta e të bardha të një harte.“

„A mund të takohemi?“

„Kështu papritmas nuk jam në dispozicion. Por, nëse e shihni me vend, unë mund t'ju takoja në Ordu dhe t'ju përcillja.“

Shikova nga dritarja. Drita e dhjetorit ishte e qartë dhe e vrazhdë. Qyteti kishte ndryshuar. Unë kisha ndryshuar.

Po filloja edhe një herë.

PJESA E DETIT ME ARARATIN

Dita e mbërritjes sime në Jerevan kishte filluar me një ulje të aeroplanit plot shkundje. Salla e aeroportit ishte pothuajse e zbrazët, përveç disa bashkudhëtarëve dhe disa personave të lodhur të sigurimit, shiriti i valixheve u zgjua nga një gjumë i thellë. Menjëherë pas hapjes së derës së fundit lëvizëse, lexova emrin tim në një shenjë kartoni të mbajtur më nge dhe isha e lehtësuar që vërtet po më prisnin.

„Helenë Mazaviani? Unë quhem Levon Petrosian, mirëserdhët në Jerevan“, tha ai burri në rusisht. Ai duhej të më sillte në apartamentin, ku do të banoja javët e ardhëshme. Unë, megjithatë, ngula këmbë që të shkonim drejt në institut. Po binte shi. Fshesat përshkëllinin mëngjesin e tetorit në xhamin e përparmë të veturës. Shoferi im ishte i pafjalë, dhe unë heshtazi i isha mirënjohëse për këtë.

Një rrugë përpjetë çonte në Matenadaran¹, i hirtë dhe hijerëndë ngrihej Arkivi Qendror i dorëshkrimeve armene, në një mur prej shkëmbi mbi luginën e qytetit. Këtu, pra, do të punoja gjatë tre muajve të ardhshëm.

„A jeni e sigurtë se doni të prisni? Është shumë herët, dhe këtu do të zgjatë derisa ta hapin.“

„Unë pres me kënaqësi.“

Ai u duk i kënaqur, ngriti supet, e çoi valixhen time në oborrin e institutit, më uroi kohë të mirë. Pas disa metrash, ndaloi prapë dhe hapi xhamin.

„Nëse ju pëlqen xhazi, në Rrugën Abovjan gjendet një bar, aty luaj nganjëherë. Nuk është larg nga banesa juaj.“

„Xhaz?“

„A merrni vesh nga xhazi?“

1 Matenadaran (armenisht: Մատենադարան), Instituti „Mesrop Mashtoc“ i Dorëshkrimeve të Hershme.

„Jo.“

„Jeni megjithatë e mirëpritur.“ Dhe iku.

Ndoqa me sy veturën tek largohej. Levon Petrosian. Një mjegull e lehtë varej mbi qytet.

Ishte ftohtë, u mbështolla më fort me mantelin tim dhe nisa të ecja andej-këndej, shëtita deri tek përmen-dorja e Mesrop Mashtocit.² I errët dhe madhështor ishte i ulur babai i alfabetit armen në pedestal, para këmbëve të tij përkulej nxënësi i tij Koryun. U mbështeta në dorën e tij të ftohtë dhe shikoja së bashku me të tiparet e rrepta të mësuesit. Rrugën Abovyan mund ta mbaja mend. Abovyan. Petrosian. Mazavian. Papritur mbi-emri im ishte në një shoqëri fonetike. Deri tani e kisha mbajtur si një rrobe të papërshtatshme, si një kapelë të shtrembër, të cilën nuk e hiqja as kur haja bukë.

Isha rreth dhjetë vjeçe, dhe të gjitha kukullat e mia quheshin si unë – Helena. Gjatë lojës përdorja motërzime si Helli, Helen, Helene që mos të më ngatërroheshin. Me mua banonin pesë Helena dhe dy kanarina. Jetoja në një shtëpi me nënën time Sarën. Nëna e kishte atelienë e saj në bodrum. Në një ditë me vapë, pak para pushimeve verore, u ktheva nga shkolla në shtëpi dhe menjëherë vrapova drejt dhomës time që të shihja kanarinat. Zogjtë jetonin, por diçka mungonte. Vështrova përreth, shtrati im me mbulesën e gjelbër gjendej aty, posterët në mur. Por kukullat mungonin dhe, pos tyre, edhe ariu dhe derrkuci im. Zbrita shkallët për tek atelieu i Sarës. Në korridor vinte era ngjyrë dhe

2 Mesrop Mashtoc (në armenisht: Մեսրոպ Մաշտոց, 362 - 17 shkurt 440 AD) gjuhëtar, kompozitor, teolog dhe hartues himnesh në Perandorinë Sasaniane. Çmohet si shenjtor në Kishën Apostolike Armene, në Kishën Katolike Armene dhe në Kishën Ortodokse dhe Romano-Katolike Lindore Armene. Njihet si hartuesi i alfabetit armen rreth vitit 405.

tretës, dera ishte e mbyllur. Trokita me sa fuqi kisha. Ç'ka ndodhur? Hape derën! Dëgjoja hapat e saj të lehtë nëpër dyshtemenë prej guri. A, ti qenke kthyer, a keni humbur orë mësimi? Ora është një e gjysmë, dhe çdo ditë kthehem në këtë kohë. Hyra duke u tkurrur pranë saj. Së pari vura re ariun, pa kokë, pastaj pashë pjesë të kukullave të mia dhe derrkucin dhe disa nga vizatimet e mia dhe fotografi të shpërndara nëpër dyshteme para telajos. Këtu një dorë, atje një kokë, e të tjerat ishin ngjitur në një dërrasë druri dhe ishin përshtetë me ngjyrë, e, në mesin e tyre, fotografi të fëmijëve të vdekur. Ato i kisha parë edhe më herët. Fëmijë armenë të vdekur në bardh e zi dhe në sepia nuk ishin më diçka e re. Sara, që, prej vitesh, i ngjiste ato në pikturat e saja. Ajo qëndronte në mes të asaj rrëmuje dhe pinte cigare. Unë nuk thashë gjë e as ajo nuk tha gjë. Kukulla me flokët kaçurrela varej pranë një fotografie të një trupi skeletor të një vajze të vdekur. Trupi ishte në pluhur dhe, për herë të parë, e kuptova se fotografitë tregonin njerëz të vërtetë. Kisha menduar se një fëmijë nuk mund të ishte kaq i vdekur.

Shkunda këpucën duke i mëshuar në këmbë Mesrop Mashtocit për të hequr gjethet ngjitëse, u ula mbi valixhe dhe i dërgova mesazh Danilit: *Erdha mirë*.

Nga lëvizjet e turbullta të veturave dhe të kalimtarëve doli një trup që u çapit rrugës përpjetë, drejt Matendaranit, me hapa të rrëmbyeshëm.

„Më ka lajmëruar im bir, si ka mundur t'ju lërë këtu në këtë kohë? Më vjen shumë keq dhe kërkoj ndjesë. Mirëserdhe Helenë, unë jam Evelina Stepanovna Petrosian.“

Gruaja trupvogël ishte zbehur nga mundimi dhe nuk u qetësua as kur u përpoqa t'ia mbushja mendjen se unë vetë kisha ngulur këmbë të prisja këtu. Djali i saj qënkej

një dembel, edhe pse ka merita të mëdha për këtë vend, por megjithatë është dembel.

Evelina më kaloi përtej portës me roje drejt punëtorive të arkivit qendror. U desh mjaft kohë derisa i gjithë stafi mbërriti atje dhe, më në fund, arrita t'i hidhja një sy atij objekti. Pra, një ungjill shërues i përdorshëm, mrekullitë shëruese të Krishtit, *ngrihu dhe ec, hapi sytë dhe shih*, i shkruar, sipas vlerësimeve, përfundimisht rreth vitit 1710, dhe, për shkak të dëmtimeve të mundshme nga lagështia, libri ishte valëzuar dhe i qe dëmtuar lidhja. Mbështjellje e plotë lëkure, ndoshta lëkurë viçi, gravura për të verbër, pesëmbëdhjetë centimetra e gjerë dhe njëzet e një centimetra e gjatë. Në qoshe dhe në pjesën kryesore mungojnë ca pjesë, në kopertinën e parë dhe të pasme: gjurmë grisjeje dhe gërvishtjeje. Mbetjet e kapakut të pasëm të librit – veshët që janë karakteristikë e dorëshkrimeve armene – ishin të ngjitur në pjesën e brendshme të kapakut të pasëm. Nga veshi kishte shpëtuar vetëm një e treta. E peshoja në duar, një bostan i vogël, një gur jo aq i madh. E përshkova me dorë shpinën e librit, ishte e cekët si dorëshkrimet orientale.

„Ju duhet të jeni lodhur nga udhëtimi.“

„Përkundrazi.“

Evelina, megjithatë, më largoi, një dorëshkrimi të vjetër i nevojitet një shpirt që ka fjetur mirë dhe duar të qeta, ndaj edhe tërhoqa valixhen nëpër trotuarin e dëmtuar deri para një ndërtese katërkatëshe të stilit parafabrikat, në një rrugë me një emër që shqiptohej vështirë, Tpagrichner. Hyrja ishte nga oborri pranë një sheshi lojërash për fëmijë. Në ndriçimin e zbehtë të shkallëve e gjeta derën në katin e dytë. Atje, pas një dhome ndenjjeje me një kënd kuzhine, kishte edhe një dhomë gjumi, një banjo. Në një raft në korridor kishte një shënim: Mirë se vini, Helene Mazavian, shijoni

qëndrimin tuaj! Unë e inspektova dushin: ai mund të përhapte drita shumëngjyrëshe dhe muzikë. Në dhomën e gjumit gjendej një shtrat i madh me një mbështetëse, shkërbim i lëkurës së gjarprit në ngjyrë pembe të zbehtë. Nga shtrati këqyra qiellin. I hoqa fotografitë nga muri, – një pjesë e detit dhe një Ararat³ i mbuluar me borë, – i futa pas dollapit dhe vendosa një foto të Danilit mbi shtrat. Shikimi i tij i njohur, i dashur, dhe pak përtallës. Vura këpucët në korridor, vendosa rrobat në dollap. Kishte një uji, por pak varëse rrobash. Hapa dritaren dhe shikova në oborr. Vinte era vjeshtë. Një burrë qëndronte afër kolovajzës dhe fliste me telefon. Me dorën e lirë i binte atij gypit të ndryshkur. „Dikranian, a më dëgjon?“⁴, thërriste i zemëruar rusisht.

Dikranian. Abovyan. Petrosian. Mazavian. E mbylla dritaren. Mbi tavolinën e rrumbullakët në dhomën e ndenjjes gjendej një pjatë me shegë. Të kuqe, si ajo e kuqja në dorëshkrimet armene. Drurët e kuq, dheu i kuq, deti i kuq, goja e ferrit, kopshti i parajsës, lumenjtë Kishon, Gihon, Tigris dhe Eufrat, e kuqja e fituar nga morri armen Kermes, në agun e mëngjesit, i tërhequr me kujdes nga një gjethe e gjelbër, i zier me acid sulfurik, i tharë, i bluar për pigment ngjyre. Asnjëra nga të dyja thikat në sirtar nuk hynin në punë për të qëruar shegët. Nxora briskun tim, një prerje, dhe bluza ime u spërkat me të kuqe. Shkrova në një copë letër: sapun kundër njollave, varëse rrobash, thikë kuzhine. Pastaj qëndrova në mes të dhomës dhe nuk mund të vendosja se si të ndjehesha, e vetmuar, apo e kënaqur.

I telefonova Danilit, e lashë telefonin të cingëronte gjatë. E shihja tek kërkonte telefonin, dëgjova një gogësimë të lehtë.

„Ç’ka të re nga Kaukazi?“

3 Mali Ararat, vend ku besohet se u ndal Arka e Noes.

„Kaukazi është i errët.“
„Si ishte udhëtimi?“
„Në Moskë më është dashur të pres gjatë.“
„Si është banesa?“
„Interesante.“
„Tjetër gjë?“
„Vetëm edhe unë.“
„Të puth, zhabë.“